



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRI

Nr. 3510 Prot.

Tiranë 09.7.2013

UDHËZIM

Nr. 13, datë 9.7.2013

PËR

**MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË SESIONIT TË DYTË TË  
PROVIMEVE TË LIRIMIT DHE TË MATURËS SHTETËRORE 2013**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe të Vendimit të Këshillit Ministrave, Nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ:

**KREU I**

**SESIONI I DYTË I PROVIMEVE TË LIRIMIT**

1. Provimet e sesionit të dytë të Provimeve të Lirimit 2013, të zhvillohen në datat si më poshtë:
  - a. Gjuha shqipe dhe letërsia 03 shtator 2013
  - b. Matematika 05 shtator 2013
2. Në sesionin e dytë, provimet e Lirimit të fillojnë në orën 10:00.
3. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në "Rregulloren për Provimet e Lirimit në Republikën e Shqipërisë" Nr.154, date 11.01.2013
4. Provimet e Lirimit zgjasin 2 orë e 30 minuta

## PROVIMET E SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE

2. Provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2013, të zhvillohen në datat:
  - c. Gjuha shqipe dhe letërsia 17 shtator 2013
  - d. Matematika 19 shtator 2013
  - e. Provimet me zgjedhje 21 shtator 2013
3. Në sesionin e dytë, provimet e Maturës Shtetërore të fillojnë në orën 09:00.
4. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 kërkesa, nga të cilat 13 kërkesa të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, kurse 12 kërkesa të jenë me zhvillim dhe të vlerësohen me 37 pikë.
5. Provimet e lëndëve të detyruara të zgjasin 2 orë e 30 minuta secila. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në "Rregulloren për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë" Nr. 818, datë 06.02.2013.
6. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, kurse 20 pyetje të jenë me zhvillim dhe të vlerësohen me 30 pikë.
7. Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.
8. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje do të hyjnë në orën 10.00

### KREU II

#### MATURANTËT/KANDIDATËT QË DO TË MARRIN PJESË NË PROVIMET E SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE 2013

9. Në provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2013 kanë të drejtë të marrin pjesë:
  - a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime në sesionin e parë të Maturës Shtetërore 2013;
  - b) Maturantë që rezultuan mbetës në vitin shkollor 2012-2013 dhe i shlyejnë provimet shkollore në datat 4 dhe 6 shtator 2013;
  - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2013, por nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe për arsye të ndryshme, nuk kanë plotësuar formularin A1Z.
  - d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë njehsuar dokumentet shkollore në Komisionin e posaçëm të ngritur në MASH.

10. Për maturantët e pikave 9/a,b është i vlershëm Formulari A1 për dhënien e provimeve të sesionit të dytë.
11. Kandidatët e pikave 9/c,d, që do të japin provimet në sesionin e dytë, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që i cakton DAR/ZA e vendbanimit. Për këtë kategori plotësimi i Formularit A1Z do të bëhet nga data **2 deri 11 shtator 2013**.
12. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2013, në datën **12 shtator 2013**. Drejtori i DAR/ZA-së dërgon këtë listë në AKP në datën **12 shtator 2013**.

### **KREU III**

#### **ADMINISTRIMI I PROVIMEVE**

13. Provimet të zhvillohen të përqendruara në Drejtoritë Arsimore Rajonale.
14. ZA Tropojë, ZA Lushnjë dhe ZA Sarandë i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre. ZA Delvinë i zhvillon provimet në qytetin e Sarandës.
15. Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe drejtoritë e shkollave marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do zhvillohen provimet sesionit të dytë.
16. Drejtori i DAR-së, brenda datës **9 shtator 2013**, njofton zyrtarisht AKP-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e sesionit të dytë.
17. Në DAR-të ku rezulton se numri i maturantëve/kandidatëve është me i madh se 500, mund të përdoren 2 mjedise.
18. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2013 të bazohet në "Rregulloren për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë" Nr. 818, datë 06.02.2013.

### **KREU IV**

#### **HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE 2013**

19. Procedurat e hartimit të testeve të provimeve të detyruara dhe me zgjedhje në sesionin e dytë, përcaktohen nga AKP.



20. Pas zhvillimit të çdo provimi të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2013, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen nën masa të rrepta sigurie në godinën e AKP-së.
21. Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore 2013, të ndjekë procedurat e përcaktuar në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2013.

## KREU V

### DISPOZITA TË FUNDIT

22. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2013, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.
23. Shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe ushqimit të specialistëve të përfshirë në këtë proces të mbulojnë nga institucionet përkatëse.
24. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP-ja, IKAP-i, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrrat Arsimore.

MINISTRI



Myqerem TAJAJ

